

VENDIM
Nr.1305, datë 29.12.2009

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.1253, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË
VLERËSIMIT PËR DËMSHPËRBLIMIN E PËRFITUAR NGA ISH-TË DËNUARIT
POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 34 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarëve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1253, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës I/A/4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Për kërkesat e paraqitura nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, Ministri i Financave vepron dhe i dërgon menjëherë përgjigjen zyrtare Ministrisë së Drejtësisë.”.

2. Pas pikës I/B/5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Për kërkesat e paraqitura nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, Enti Kombëtar i Banesave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme veprojnë dhe japin përgjigje zyrtare menjëherë.”.

3. Pas pikës II shtohet pika II/1, me këtë përmbajtje:

“II/1. Ministri i Drejtësisë, pas mbërritjes së formularit të plotësuar nga ish-i dënuari politik ose i afërmi i tij, bën identifikimin sipas llojit të dënimit dhe i dërgon Ministrisë së Financave një kopje të formularit të plotësuar vetëm për të dënuarit, që përfitojnë dëmshpërblim të drejtpërdrejtë, dhe i kërkon të verifikojë përfitimet në të holla dhe letra me vlerë të ish-të dënuarve politikë, në përputhje me ligjet e mëparshme. Nuk dërgohen për verifikim formularët e plotësuar nga të dënuarit me internim/dëbim. Kjo kategori, sipas ligjit, trajtohet me skemë pensioni.”.

4. Pas pikës III shtohet pika III/1, me këtë përmbajtje:

“III/1. Institucionet e parashikuara nga pika I e këtij vendimi, lidhin memorandum bashkëpunimi ndërmjet tyre për përshpejtimin e procedurave e të afateve të vlerësimit për dëmshpërblimin e përfituar nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist të mbetur gjallë dhe për komunikimin zyrtar ndërmjet tyre.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha